



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/137
Datë: 14.03.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 14 mars 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Shoqëritë Tregtare.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/137
Datë: 14.03.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2011, dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e Ministrisë së Financave të datës 24.02.2017 me nr. protokolli 532, në mbledhjen e mbajtur më 14 mars 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin e Vendimit Nr. 06/17, të datës 07 mars 2015

1. Ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 1.7 i Vendimit të Qeverisë nr. 06/17 i datës 07.03.2015 për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kosovar për Raportim Financiar, si në vijim:
 - 1.1. Anëtari nga odat tjera ekonomike, zgjidhet me rotacion, me mandat një (1) vjeçar, në bazë të regjistrit të odave ekonomike të cilat veprojnë në Kosovë dhe janë anëtare të Këshillit Kombëtar të Zhvillimit Ekonomik të Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/137
Datë: 14.03.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 14 mars 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Financave për negocimin e "Marrëveshjes për Financim shtesë për Projektin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural" ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Financave që të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/137
Datë: 14.03.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 14 mars 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për miratimin e "Protokollit shtesë numër 5, për Marrëveshjen për ndryshimin dhe Aderimin në Marrëveshjen për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore".
2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që të zhvillojë negociata në kuadër të Marrëveshjes për ndryshimin dhe Aderimin në Marrëveshjen për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/137
Datë: 14.03.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 9, 10, 44 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, datë 13.02.2017, nr. prot. 382, në mbledhjen e mbajtur më 14 mars 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave private, komunale dhe shoqërore të cilat preken nga ndërtimi i "Zonës Ekonomike - Industriale" përballë "Parkut të Biznesit në Drenas", përkatësisht Zona Kadastrale Sankoc, Komuna Drenas, sipas tabelës të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik dhe sipërfaqeve të tyre, e cila tabelë është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Financave dhe Komuna e Drenasit.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/137
Datë: 14.03.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 10 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, datë 13.02.2017, nr. prot. 381, në mbledhjen e mbajtur më 14 mars 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i ndërtesave të përhershme të menaxhimit të integruar të kufirit (IBM) mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë: Pika Kufitare Bërnjak, Zona Kadastrale Banjë, Komuna Zubin Potok për pjesët e parcelave nr. 1564-0 me sipërfaqe prej 1749m², nr.1565 me sipërfaqe prej 172m², nr.1568 me sipërfaqe shtesë prej 382m², nr.1576 me sipërfaqe shtesë prej 144m², nr.1560 me sipërfaqe shtesë prej 5244m², nr.1561 me sipërfaqe shtesë prej 1686m², nr.1562 me sipërfaqe shtesë prej 1420m², nr.1910 me sipërfaqe shtesë prej 4450m², nr.1563 me sipërfaqe shtesë prej 782m², Pika Kufitare Merdar, Zona Kadastrale Merdar, Komuna Podujevë, për pjesët e parcelave nr. 47-0 me sipërfaqe prej 1992m² nr.51-1 me sipërfaqe shtesë prej 1228m² nr.51-2 me sipërfaqe shtesë prej 1101m² nr.51-3 me sipërfaqe shtesë prej 271m² nr.53-2 me sipërfaqe shtesë prej 345m², nr.50-0 me sipërfaqe shtesë prej 1543m², nr.15-1,15-2 me sipërfaqe shtesë prej 219m², nr.13-0 me sipërfaqe shtesë prej 102m², nr. 49-0 me sipërfaqe shtesë prej 256m², nr.48-0 me sipërfaqe shtesë prej 65m², nr.545 me sipërfaqe shtesë prej 195m², nr.16-0 me sipërfaqe shtesë prej 80m², nr.544-2 me sipërfaqe shtesë prej 1147m², nr.56-1 me sipërfaqe shtesë prej 1043m², nr.55-3 me sipërfaqe shtesë prej 638m², nr.55-4 me sipërfaqe shtesë prej 908m² dhe Pika Kufitare Mutivodë, Zona Kadastrale Dabishevc, Komuna Prishtinë, për pjesët e parcelave nr.335-1 me sipërfaqe shtesë prej 328m², nr. 335-2 me sipërfaqe shtesë prej 109m², nr. 335-3 me sipërfaqe shtesë prej 244m², nr. 335-4 me sipërfaqe shtesë prej 2416m², nr. 322-0 me sipërfaqe shtesë prej 1204m², nr. 316-1 me sipërfaqe shtesë prej 539m², nr. 1375-0 me sipërfaqe shtesë prej 1053m², nr. 1374-0 me sipërfaqe shtesë prej 289m², nr. 328-1, 328-2 me sipërfaqe shtesë prej 1111m², sipas pozitës se tyre në kuadër të projektit dhe situacionit grafik të tyre, të përshkuara në tabelat të cilat parqesin pjesët përbërëse të këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit(MMPH), Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Brendshme.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 07/137
Datë: 14.03.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 14 mars 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncepti Dokumenti për Tokën Ndërtimore.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/137
Datë: 14.03.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 14 mars 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 7,000.00 (shtatë mijë) euro për Projektin e ri "Blerja e Pajisjeve për Laboratorin Toksikologjik".
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë, nën - programi Shpenzimet e paparashikuara me kod 13100 dhe barten në Ministrinë e Drejtësisë me kod (215) në programin Departamenti për Mjekësi Ligjore me kod 33700, në kategorinë e Shpenzimeve Kapitale, në Projektin e ri "Blerja e Pajisjeve për Laboratorin Toksikologjik".
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/137
Datë: 14.03.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 14 mars 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë për ndarjen e mjeteve financiare në shumën e përgjithshme prej 100.000 (njëqindmijë) euro, si në vijim: shuma prej 78,000 (shtatëdhjetetëmijë) euro për kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve dhe shuma prej 22,000 (njëzetedymijë) euro për kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë me kod 232, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, dhe barten në Ministrinë e Drejtësisë me kod 215, në nën programin Departamenti për Profesione të Lira me kod 31700, në kategorinë Subvencione dhe Transfere, në nën zërin buxhetor Subvencione për etnitete jo publike me kod 21200 shuma prej 78.000 (shtatëdhjetetëmijë) euro për kompensimin e viktimave të krimit, dhe në kategorinë Mallra dhe Shërbime, në nën zërin buxhetor Shërbime të Ndryshme Intelektuale dhe Këshillëdhënëse me kod 13440 shuma prej 22.000 (njëzetedymijë) euro, për kompensimin e Komisionit për kompensimin e viktimave të krimit.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/137
Datë: 14.03.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 14 mars 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti i tretë mbi Planifikimin dhe Implementimin e 'Klauzolës për Investime'.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi ta përcjellë në Kuvendin e Republikës së Kosovës për informim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/137
Datë: 14.03.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 14 mars 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Informata e prezantuar nga Ministri i Financave, lidhur me Raportin për performancën e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore për periudhën janar - shkurt 2017.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/137
Datë: 14.03.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 14 mars 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Informata e prezantuar nga Ministrja e Integritimit Evropian, lidhur me Takimin e Nën Komitetit të MSA-së për Bujqësi dhe Peshkatari.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/137
Datë: 14.03.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 14 mars 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Projektligji për Pagat tërhiqet nga procedurat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin bashkë me kërkesën për tërheqjen e Projektligjit nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë